



Pranuar / Dorezuar Punlyena/Priloz Received/Delivery	16 - 11	2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedrnica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKANSHEK	7016/2023		1/6	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1174/2023

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave** në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë; me Ardita Perçuku Shtyti, Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1174/2023, të datës 18.09.2023, të parashtruar nga ankuesi nga Prishtina, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6, paragrafin 1; Nenin 16, paragrafi 3 dhe Nenin 18, paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.11.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.1174/2023, e datës 18.09.2023, e parashtruar nga ankuesi
- II. **Shfuqizohet** Vendimi me numër DM 676/2023, i datës 15.09.2023, i Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
- III. **Anulohet** Raporti i Punës 05/2023 dhe Raporti i Punës 06/2023 i Komisionit të Ristrukturimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ndërsa lënda kthehet në Komisionin e Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
- IV. **Obligohet** Komisioni i Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmer të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi, duke marr parasysh pikëpamjet e dhëna në arsyetimin e këtij vendimi.
- V. **Obligohet** Drejtori Ekzekutiv i Agjencinë Kosovare të Privatizimit, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën III të këtij dispozitivi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## Arsyetim

Nëpunësi civil (tutje vetëm ankuesi) më datë 18.09.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr.1174/2023, kundër Vendimit me numër DM 676/2023 të datës 15.09.2023 të Departamentit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, konstatimit të gabuar të gjendjes së fakteve dhe aplikimit të gabuar të ligjit material.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme vetëm Këshilli) në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.09.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia Kosovare e Privatizimit, ndërsa, kjo e fundit, më datë 03.10.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar kësaj çështje juridiko-administrative.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokolli 6798/2023, të datës 31.10.2023, ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.1174/2023 të datës 18.09.2023.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 18.09.2023 me Nr.Prot.6142/2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Raportin e punës 06/2023 të datës 12.09.2023 të Komisionit të Ristrukturimit në AKP; Listën me poentimin e kandidatëve pjesëmarrës lidhur me sistemin e pikëzimit për vlerësimin e performances, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve relevante me pozitën; Listën e poentimit në sistemin e pikëzimit për vlerësimin e performances, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për kandidatin M.A së bashku me shkresat e bashkangjitura; Listën e poentimit në sistemin e pikëzimit për vlerësimin e performances, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për kandidatin (ankuesin) R.Z së bashku me shkresat e bashkangjitura; Listën e poentimit në sistemin e pikëzimit për vlerësimin e performances, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për kandidatin A.F së bashku me shkresat e bashkangjitura; Listën e poentimit në sistemin e pikëzimit për vlerësimin e performances, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për kandidatin L.G së bashku me shkresat e bashkangjitura; Vendimin me numër DM 676/2023 të datës 15.09.2023 të Departamentit të Burimeve Njerëzore në AKP; Vendimin me Nr.705/2022 të datës 29.04.2022 të Sekretares së Përgjithshme në MPB; Udhëzuesin me Nr.02/2022 për Procesin e Riorganizimit të Institucioneve Publike dhe Sistematizimin e Nëpunësve pas Ristrukturimit; Vendimin e datës 29.08.2023 të Departamentit të Burimeve Njerëzore në AKP; Plotësimin e ankesës së ankuesit të datës 29.09.2023 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Komunikimin elektronik të datës 29.09.2023 nga ankuesi për Burimet Njerëzore në AKP; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 26.09.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Diplomat e ankuesit të datës 22.07.2002, 05.01.2000, 25.06.2005, 08.03.2006, 02.11.2006 nga The Cambridge School në Prishtinë; Procesverbalin e takimit të mbajtur të datës 30.09.2023 nga Komisioni i Ristrukturimit në AKP; Ankesën e ankuesit Ramë Zagragaj me numër protokolli 4826/2023 të datës 19.06.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Raportin e punës me numër 05/2023 të datës të Komisionit të Ristrukturimit; Tabelën për sistemin e pikëzimit për vlerësimin e performances, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për ankuesin; Tabelën për sistemin e pikëzimit për vlerësimin e performances, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për ankuesin-Vjetërsia e nëpunësit civil në shërbimin civil për ankuesin; Tabelën për sistemin e pikëzimit për vlerësimin e performances, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për ankuesin-Kualifikimi profesional për ankuesin; Vendimin nën shenjë DM 193/2023 të

datës 23.05.2023 të Departamentit të Burimeve Njerëzore; Njoftimin përmes e-mailit zyrtar të datës 31.05.2023 nga Drejtori Menaxhues; Vendimin me Nr.705/2022 të datës 29.04.2022 të Sekretares së Përgjithshme të MPB-së; Udhëzuesin Nr.02/2022 për Procesin e Riorganizimit të Institucioneve Publike dhe Sistematizimin e Nëpunësve pas Ristrukturimit; Certifikatat e ankuesit të bashkangjitura në shkresat e lëndës; Diplomën e ankuesit me Nr.3545 të datës 02.10.2018 nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Ekonomik; Vërtetimin e punësimit me Nr.1023 të datës 21.03.2023 për ankuesin nga AKP-ja; Përshkrimin e punës për pozitën Drejtor i departamentit të shitjes; Vendimin me numër A.nr.451/2023 të datës 18.04.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër të referencës RN00011161 të datës 15.03.2023; Tabelën për sistemin e pikëzimit për vlerësimin e performances, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për kandidatin L.G; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 21.07.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 27.07.2023 nga Agjencia Kosovare e Privatizimit së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Vendimin me Nr.Ref.BD-173/3 të datës 30.11.2022 nga Zëvendës Kryesuesja e Bordit të Drejtorëve të AKP-së; Organogramin e AKP-së; E-mailin zyrtar të datës 06.12.2022 nga AKP për gjithë stafin; Akt emërimit e ankuesit me reference 172/DSH 1 të datës 10.01.2023; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i departamentit të shitjes; Vendimin DM 1118/2022 të datës 14.12.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Vendimin DM 37/2023 të datës 14.02.202 nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Vendimin DM 184/2023 të datës 12.05.2023 nga Njësia e Burimeve Njerëzore; E-mailin zyrtar të datës 22.12.2022 E-mailin zyrtar të datës 06.12.2022 nga AKP për gjithë stafin; E-mailin zyrtar të datës 23.12.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore për ankuesin; E-mailin zyrtar të datës 23.01.2023 nga ankuesi për Burimet Njerëzore; Vendimin DM 27/2023 të datës 06.02.2023 nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i departamentit të realizimit të aseteve dhe shpërndarjes të datës 06.02.2023; E-mailin zyrtar të datës 13.02.2023 nga Burimet Njerëzore për nëpunësit e AKP-së; Vendimin Nr.Ref.BD-176/2 të datës 14.02.2023 nga Zëvendës Kryesuesja e Bordit të Drejtorëve të AKP-së; E-mailin zyrtar të datës 15.02.2023 nga Njësia e Burimeve Njerëzore për ankuesin; E-mailin zyrtar të datës 15.03.2023 nga AKP për gjithë stafin; Tabelën për sistemin e pikëzimit për vlerësimin e performances, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për kandidatin M.A; Tabelat për sistemin e pikëzimit për vlerësimin e performances, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për kandidatin M.A lidhur me vjetërsinë e nëpunësit civil në shërbimin civil; Tabelat për sistemin e pikëzimit për vlerësimin e performances, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për kandidatin A.F; Tabelën për sistemin e pikëzimit për vlerësimin e performances, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për kandidatin L.G; Dosjen e kandidatit M.A së bashku me shkresat e bashkangjitura lidhur me përvojën e punës, atë profesionale dhe trajnimeve dhe atë: Diplomën nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti i Shkencave Teknike të Aplikuara për vitin akademik 2004/05; Licencën me Nr.01/2021 të datës 07.06.2021 për Ushtrimin e funksionit të administratorit falimentues nga Ministria e Drejtësisë; Certifikatat e trajnimeve të bashkangjitura sikurse në shkresat e lëndës; Diplomën me Nr.28/10 të datës 16.11.2010 të lëshuar nga Universiteti Mbretëror Iliria-Fakulteti i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë; Kontratën e punësimit të datës 30.12.2010 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Kontratën e punësimit të datës 28.01.2011 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Kontratën e punësimit të datës 22.12.2009 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Formularin e kërkesës për personel të datës 11.11.2009 tek AKP; Kontratën e punësimit të datës 22.04.2009 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Kontratën e punësimit të datës 06.02.2009 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Formularin e kërkesës për personel të datës 24.12.2009 tek AKP; Kontratën e punësimit të datës 08.01.2009 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Kontratën e punësimit të datës 28.10.2008 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Kontratën e punësimit të datës 22.06.2012 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Akt emërimit me nume reference 188/DL 1 të datës 26.12.2012; Akt emërimit me nume reference 213/DKL 1 të datës 05.08.2014; Akt emërimit me nume reference 137/DKL 1 të datës 28.12.2022; Ndryshimin dhe plotësimin e Akt emërimit me numër 26/ZDM-L 1 të datës 20.06.2023; Dosjen e ankuesit R.Z së bashku me shkresat e bashkangjitura lidhur me përvojën e punës, atë profesionale dhe trajnimeve dhe atë: Kontratën e punësimit

të datës 07.02.2011 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Kontratën e punësimit të datës 28.01.2011 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Formularin e kërkesës për personel të datës 11.12.2010; Kontratën e punësimit të datës 23.12.2009 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Formularin e kërkesës për personel të datës 11.12.2009; Kontratën e punësimit të datës 27.03.2009 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Kontratën e punësimit të datës 28.12.2011 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Deklaratën e datës 28.12.2011; Akt emërimit me numër reference 223/DSH 1 të datës 27.12.2012; Akt emërimit me numër reference 174/DSH 1 të datës 27.04.2015; Akt emërimit me numër reference 172/DSH 1 të datës 10.01.2023; Dosjen e kandidatit L.G së bashku me shkresat e bashkangjitura lidhur me përvojën e punës, atë profesionale dhe trajnimeve dhe atë: Diplomën me Nr.037/10 të datës 24.01.2011 të lëshuar nga Kolegji Victory; Diplomën me Nr.302/15 të datës 11.06.2015 të lëshuar nga Kolegji Victory; Kontratën e punësimit të datës 23.04.2012 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Kontratën e punësimit të datës 28.12.2011 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Deklaratën e datës 30.12.2011; Kontratën e punësimit të datës 29.12.2010 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Formularin e kërkesës për personel të datës 24.12.2010; Kontratën e punësimit të datës 29.12.2010 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Formularin e kërkesës për personel të datës 16.08.2010; Kontratën e punësimit të datës 28.12.2011 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Deklaratën e datës 30.12.2011; Akt emërimit me numër reference 252/DSH 23 të datës 27.12.2012; Akt emërimit me numër reference 178/DSH 23 të datës 01.08.2014; Akt emërimit me numër reference 57/DSH 6 të datës 24.08.2017; Akt emërimit me numër reference 37/DKP 1 të datës 06.09.2018; Akt emërimit me numër reference 54/DKP 1 të datës 28.12.2022; Certifikatën e trajnimit të bashkangjitur sikurse në shkresat e lëndës tek CEED; Dosjen e kandidatit A.F së bashku me shkresat e bashkangjitura lidhur me përvojën e punës, atë profesionale dhe trajnimeve dhe atë: Diplomën me Nr.535/10 të datës 05.09.2010 të lëshuar nga Universiteti AAB; Diplomën me Nr.41/21 të datës 19.05.2021 të lëshuar nga Kolegji Iliria; Kontratën e punësimit të datës 30.12.2010 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Kontratën e punësimit të datës 23.12.2009 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Formularin e kërkesës për personel të datës 11.11.2009; Kontratën e punësimit të datës 19.10.2009 tek Agjencia Kosovare e Privatizimit; Akt emërimit me numër reference 243/DSH 21 të datës 30.12.2011; Deklaratën e datës 30.12.2011; Akt emërimit me numër reference 152/DMMPI 1 të datës 30.12.2022; Akt emërimit me numër reference 231/DVSH 5 të datës 30.07.2014; Akt emërimit me numër reference 48/DMMPI 7 të datës 10.07.2017; Propozimin me Nr.KR/23 të datës 22.05.2023 nga Njësia e Burimeve Njerëzore e AKP-së; E-mailin zyrtar të datës 08.05.2023 nga DMZP për Njësinë e Burimeve Njerëzore të AKP-së; Tabela me listat e lira të nivelit të mesëm drejtues (ZKM, Ministritë dhe Agjencionet); E-mailin zyrtar të datës 24.05.2023 nga Njësia e Burimeve Njerëzore të AKP-së për A.L; E-mailin zyrtar të datës 16.05.2023 nga DMZP për Njësinë e Burimeve Njerëzore të AKP-së si dhe E-mailat zyrtar të datës 05.06.2023 ndërmjet Njesisë së Burimeve Njerëzore dhe DMZP-së; Shkresën e datës 08.08.2023 me shifër:2586 prej 554 faqesh me plotësimin e ankesës së ankuesit [ ] e datës 16.08.2023 si dhe Vendimin me numër protokoll 6798/2023 të datës 31.10.2023 lidhur me vazhdimin e aftit të ankesës së ankuesit në Këshill.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar, *sepse*:

Me datën 17.08.2023, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke vendosur sipas ankesës A.nr.865/2023 të datës 19.06.2023 të parashtruar nga ankuesi [ ] si dhe ankesës A.nr.868/2023 të datës 20.06.2023 të parashtruar nga ankuesi [ ] e pas bashkimit të ankesave përmes Vendimit VK/2023 të datës 03.08.2023 nga ana e Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin A.nr.868/2023 ka anuluar Raportin e Punës 05/2023 të Komisionit të Ristrukturimit lidhur me procedurën e transferimit në pozitën "Drejtor i Departamentit të Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjes", Vendimin DM 194/2023 të datës 23.05.2023 dhe Vendimin DM

193/2023 të datës 23.05.2023 të nxjerra nga Drejtori i Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ndërsa lëndën e ka kthyer në ri-shqyrtim dhe rivendosje, duke detyruar Komisionin e Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrë veprimet juridike me qëllim të rishqyrtimit të lëndës në fjalë, ashtu që të bëhet konstatimi i saktë i gjendjes faktike dhe poentimi i kandidatëve vetëm sikurse është përcaktuar me rregullat dhe udhëzuesin në fuqi.

Komisioni i Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit ka bërë rivlerësimin e kandidatëve, me ç' rast sipas Raportit të punës 06/2023 të datës 12.09.2023, kandidati [ ] është vlerësuar me gjithsej 54 pikë, duke u renditur si kandidati me më së shumt pikë të vlerësimit, kandidati këtu ankuesi është vlerësuar më gjithsej 52.765 pikë, kandidati [ ] është vlerësuar me gjithsej 40.25 pikë, si dhe kandidati [ ] është vlerësuar më gjithsej 35.25 pikë, rrejdhimisht, ankuesi me Vendimin DM 676/2023 të datës 15.09.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore nuk është kualifikuar për pozitën "Drejtor i Departamentit të Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjeve", me ç' rast nga data 01.10.2023 është propozuar për transferim në një pozitë të lirë të së njëjtës kategori në institucion tjetër shtetëror.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër DM 676/2023 të datës 15.09.2023 të Drejtorit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, pretendon se Komisioni i Ristrukturimit të AKP-së me rastin e hartimit të Raportit vlerësues nuk e ka zbatuar drejtë Udhëzuesin 02/2022 për procesin e Riorganizimit të Institucioneve Publike dhe Sistematizimin e Nëpunësve pas ristrukturimit, i njëjti thekson se rezultati për të i dhënë se fundi ka qenë befasues ngase sipas raportit paraprak i njëjti ishte vlerësuar me 34 pikë ndërsa në bazë të vlerësimit të fundit ka marrë 52.75 pikë, po ashtu i njëjti thekson se vendimi i kundërshtuar me ankesë është i përfshirë me shkelje të parimeve themelore mbi bazën e të cilave duhet të udhëhiqet një procedurë administrative ngase nuk është njoftuar paraprakisht lidhur me ndryshimin e komisionit të ristrukturimit, se vendimi i kundërshtuar nuk përmban vërtetim të gjendjes së fakteve lidhur me procesin e vlerësimit dhe rrjedhën se si ka ardhur komisioni deri në rezultatin përfundimtar për vlerësimin e kandidatit në rastin konkret, se ristrukturimi në përgjithësi është udhëhequr me parregullsi ngase ka pasur cenim të parimit të transparencës dhe të ligjshmërisë, nga Këshilli kërkon që ta anuloj Vendimin me numër DM 676/2023 të datës 15.09.2023 si dhe Raportin Vlerësues me numër 06/2023 të Komisionit të Ristrukturimit si dhe te obligoj AKP-në që të njëjtin ta caktoj në pozitën Drejtor i Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjeve.

Në kontest të shqyrtimit të procesit të rivlerësimit lidhur me pozitën Drejtor i Departamentit të Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjes, Kolegji nga analizimi i përshkrimit të detyrave të punës për këtë pozitë, e aprovuar nga Drejtori Menaxhues i AKP-së dhe Drejtori i Departamentit të Burimeve Njerëzore me datë 06.02.2023, nga rrjedhë se si kritere janë përcaktuar: *Diplomë në fakultetin juridik, administrim biznesi, administratë publike, apo fusha tjera relevante për pozitën me 240 kredi/ECTS apo ekuivalent me to sipas Rregullores së Qeverisë për Klasifikimin e Vendeve të Punës.*

Andaj, Kolegji nga shqyrtimi i dosjes së kandidatit të përzgjedhur [ ] ka konstatuar se i njëjti posedon diplomën sipas të cilës dëshmohet se ka të përfunduar me datë 21.09.2007, Shkollën e Lartë Teknike, në kuadër të Fakultetit të Shkencave Teknike të Aplikuara, dhe ka marrë titullin Bachelor i Elektroenergjetikës në prodhimtari si dhe diplomën me nr.28/10 të datës 16.11.2010 të lëshuar nga Kolegji Privat " Iliria-" për përfundimin e studimeve master i Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Diplomacisë. Kështu që mbi bazën e këtyre fakteve, rrjedhë se kandidati i përzgjedhur [ ] nuk ka plotësuar kriteret për pozitën e punës Drejtor i Departamentit të Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjeve, sepse i njëjti nuk posedon kaulifikimin adekuat siç është përcaktuar për këtë pozitë, andaj, nisur nga ky konstatim rezulton se Komisioni i ristrukturimit me rastin e nxjerrjes se raportit të punës 06/2023 të datës 12.09.2023,

nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe në këtë mënyrë nuk ka zbatuar drejtë ligjin material duke vepruar kështu në kundërshtim me Ligjin Nr.06/114 për Zyratë Publike i aplikueshëm në kohën e procesit të rivlerësimit, përkatësisht nenin 54, ku përcaktohet se: “1. Transferimi në rast mbylljes apo ristrukturimit 1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi civil shuhet, ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion, ku nëpunësi civil është i emëruar; 2.2. në institucionin në të cilin është bashkuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 2.4. në një institucion tjetër të Shërbimit Civil. 3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet një komision ristrukturimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozitë të lirë, në të cilën ai i plotëson kërkesat e veçanta. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësisia e pranimit, në bazë të propozimit të komisionit. Si dhe Kolegji ju referua Rregullores (QRK) Nr. 14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil respektivisht nenit 14 paragrafit 5 pika 5.3. Kualifikimet profesionale të nëpunësve civil”.

Theksuar si me sipër, duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.1174/2023**

Ardita Perçuku-Shyti



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

